

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administartion

Për:	**Bali Muharremaj**, Kryetar i Komunës së Suharekës **Bexhet Kuçi**, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Suharekës	
Kopje:	Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në MAPL Njësisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	**Elbert Krasniqi**, Ministër i MAPL-së **Jeton Qela**, Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	**Erblin Hetemi**, Udhëheqës i Departamentit Ligjor, MAPL	Datë: 05.10.2026 Nr.020-607
Zyrtaret përgjegjës: 1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor 2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	**Xhevat Tafa**, Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit **Vjosa Ahmetaj**, Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmërisë se Akteve të Komunës	
Lënda:	Kërkesë për rishqyrtim të aktit	
Lloji i aktit:	Vendim i Kuvendit të Komunës së Suharekës	

I nderuar Kryetar,
I nderuar Kryesues,

Në pajtim me nenin 8 dhe 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave dhe Rregulloren (QRK) Nr. 03/2026 për Procedurën e Shqyrtimit Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të Ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë aktin e komunës si në vijim:

Vendimi 01-Nr-410-48886 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën P-72116046-02785-104
I miratuar më datë: 25.09.2026
I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 25.09.2026

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës, ***nuk është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi.***

Arsyetim

Kuvendi i Komunës së Suharekës në mbledhjen e mbajtur me datë 25.09.2026, ka miratuar Vendimin 01-Nr-410-48886 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën P-72116046-02785-104.

MAPL, konstaton se Vendimi 01-Nr-410-48886 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën P-72116046-02785-104, është në kundërshtim me nenin 13 paragrafi 2 të Ligjit NR. 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, i cili përcakton se: "*Lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbaj këto të dhëna: të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin, datën e publikimit të njoftimit dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës*".

Në rastin konkret, dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të komunës, për parcelën P-72116046-02785-104 është e paraparë të jetë afatshkurtër deri në 5 (pesë) vite edhe sipas Vendimit paraprak 01Nr.016-7453 i cili është miratuar me datë 30.01.2025, ndërsa në listën e veçantë për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale për vitin 2026 të Komunës së Suharekës afati i dhënies në shfrytëzim për parcelën P-72116046-02785-104 ZK Suharekë, është përcaktuar të jetë afatgjatë 15-99 vite.

Bazuar në të lartcekurat Kuvendi i Komunës së Suharekës duhet të ndërmerr veprime dhe brenda afatit ligjor, prej 30 ditëve, të rishqyrtoj dhe të harmonizoj aktin më legjislacionin në fuqi.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejmë në lidhje me këtë vlerësim.